

i SIGURIMET

Nr. #047-048 • Shtator-Tetor 2023 • www.bks-ks.com

Guvernatori Ismaili e drejtori Mazreku takuan drejtuesit e lartë të Këshillit të Byrove për Kartonin e Gjelbër në Bruksel

02



AKSIDENTET U RRIJEN PËR 10,41 %

12

650 MILIONË EURO

DËME U PAGUAN NGA SIGURIMET

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se nga viti 2003 e deri në fund të muajit gusht të këtij viti, kompanitë e sigurimit të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) kompensuan dëme për palët e dëmtuara në vlerë prej hiç më pak se 650 milionë euro. Sidomos gjatë viteve të fundit kemi rritje të theksuar të pagesës së dëmeve.



04

GUVERNATORI ISMAILI E DREJTORI MAZREKU TAKUAN DREJTUESIT E LARTË TË KËSHILLIT TË BYROVE PËR KARTONIN E GJELBËR NË BRUKSEL

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), z. Ahmet Ismaili takoi drejtuesit e lartë të Këshillit të Byrove në Bruksel, znj. Sandra Schëarz – Presidente dhe znj. Greet Flore – Drejtoreshë menaxhuese. Pjesë e delegacionit ishin edhe përfaqësuesit nga Byroja Kosovare e Sigurimit dhe zyrtarë të Ambasadës së Kosovës në Bruksel. Guvernatori Ismaili i informoi për zhvillimet e fundit dhe progresin në sektorin financiar, me theks në industrinë e sigurimeve në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, Guvernatori Ismaili argumentoi nevojën dhe pengesat që mungesa e Kartonit të Gjelbër shkakton për bizneset, qytetarët e vendit tonë dhe diasporën lidhur me lëvizjen e lirë. Për të arritur këtë objektiv të rëndësishëm për lëvizje të lirë të njerëzve dhe mallrave, u diskutuan mënyrat dhe aranzhmanet e mundshme për adresimin e kësaj çështjeje. Drejtuesit e lartë të Këshillit të Byrove, falënderuan delegacionin e Republikës së Kosovës për vizitën dhe u shprehën të gatshëm të shqyrtojnë mundësitë dhe aranzhmanet potenciale alternative për një zgjidhje të kësaj



çështjeje. Megjithatë, ata rikujtuan se kufizimet ligjore që vijnë nga Statuti i Këshillit të Byrove, përbëjnë sfidën kryesore që kërkon kohë për adresim. Guvernatori Ismaili theksoi përkushtimin

e BQK-së për këtë qëllim, mbështetjen nga Qeveria dhe institucionet e Republikës së Kosovës dhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur një zgjidhje në këtë drejtim.

75.2 MILIONË EURO

janë shpenzimet e Industrisë së sigurimeve gjatë periudhës janar-gusht 2023.

10,80%

është profiti i industrisë së sigurimeve gjatë periudhës janar-gusht 2023.

ARRIN NË 47,6 MILIONË EURO SHUMA DËMEVE TË PAGUARA VETËM PËR 8 MUAJ

Hiç më pakë se 47,6 milionë euro ka arritur shuma e dëmeve që kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit i kanë paguar në emër të dëmeve për palët e dëmtuara. Bërë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shihet se shuma e mjeteve të paguara për dëme për palët e dëmtuara është më e lartë për 28,33 %

Si asnjëherë më parë Industria e Sigurimeve në Kosovë ka arritur pagesë rekorde të kompensimit të dëmeve për palë të dëmtuara si në aksidente komunikacioni, ashtu edhe për çështje tjera që mbulon policia e sigurimit në vendin tonë. Gjatë dy viteve të fundit në raport me vitet paraprake vërehet një fleksibilitet i madh si në trajtim, ashtu edhe në kompensim të dëmeve për palët e dëmtuara. Bazuar në të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se hiç më pakë se 47,6 milionë euro ka arritur shuma e dëmeve që kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit i kanë paguar në emër të dëmeve për palët e dëmtuara. Bërë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shihet se shuma e mjeteve të paguara për dëme për palët e dëmtuara është më e lartë për 28,33 %.

Sami Mazreku, drejtor i Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS) tregon se si pasojë e trajtimit të shpejt dhe korrekt të dëmeve numri i lendeve nëpër Gjykata ka rënë thuajse krejt.

PAGESA NË KATËR VITET E FUNDIT

Referuar të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës shihet se gjatë muajit gusht të këtij viti kompanitë e sigurimeve si dhe BKS-ja në emër të dëmeve kanë paguar 47,6 milionë euro, deri sa në fund të muajit korrik shuma e mjeteve të paguara ishte 41.4 milionë euro. Gjithnjë bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se deri në muajin gusht të këtij viti kompanitë e sigurimeve si dhe BKS-ja në emër të pagesës së dëmeve për palët e dëmtuara kanë paguara hiç më pakë se 47.6 milionë euro, nga 37,1 sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, bazuar gjithnjë në të dhëna zyrtare shihet se gjatë periudhës janar-gusht të vitit 2021 në emër të dëmeve janë paguar 37,7 milionë euro, deri sa në periudhën janar-gusht 2020 në emër të pagesës së dëmeve për palët e dëmtuara janë paguar 29.6 milionë euro.

MUAJI	2023	2022	2021	2020
Gusht	47.6	37.1	34.7	29.6
Korrik	41.4	32.2	30.2	25.8
Qershor	35.6	27.8	26.1	21.0
Maj	30.5	22.7	21.6	17.2
Prill	25.2	17.1	17.8	14.4
Mars	20.1	13.3	13.7	12.7
Shkurt	13.2	8.2	7.8	9.6
Janar	8.2	4.4	3.9	4.9

SEKTORI NË ZHVILLIM

Të gjitha parametrat e sektorit të sigurimeve në vend kanë trend pozitiv, pra rritje të vazhdueshme nga muaji në muaj. Të hyrat gjatë periudhës janar-gusht 2023 janë më të lartë për 12.66 % në raport me periudhën e njëjte të vitit paraprak, pagesa e dëmeve është dukshëm më e lartë, numri i kontratave dhe dëmeve të paguara gjithashtu. Më poshtë përmes numrave do ta pasqyrojmë periudhën janar-gusht 2023, krahasuar me periudhën janar-gusht 2022 të sektorit të sigurimeve

PRIMET E SHKRUARA BRUTO JANAR-GUSHT 2023, KRAHASUAR ME JANAR-GUSHT 2022.

Sipas llojit	Viti 2022	Viti 2023	Dallimi në %
Aktiviteti i Jetës	4.427.632	4.552.513	+2.82%
Aktiviteti i Jo-Jetës	83.102.221	94.060.337	+13.19%
Total:	87.529.854	98.612.851	+12.66%

DËMET E PAGUARA NË PERIU DHËN JANAR-GUSHT 2023, KRAHASUAR ME PERIU DHËN JANAR-GUSHT 2022.

Sipas llojit	Viti 2022	Viti 2023	Dallimi në %
Aktiviteti i Jetës	756.479	932.289	+23.24%
Aktiviteti i Jo-Jetës	40.810.344	43.197.673	+15.97%
Total:	41.566.824	48.261.646	+16.11%

NUMRI I KONTRATAVE PËR PERIU DHËN JANAR-GUSHT 2023, KRAHASUAR ME JANAR-GUSHT 2022

Sipas llojit	Viti 2022	Viti 2023	Dallimi në %
Aktiviteti i Jetës	25.184	42.257	+67.79%
Aktiviteti i Jo-Jetës	884.136	1.025.491	+15.99%
Total:	909.32	1.067.748	+17.42%

NUMRI I DËMEVE TË PAGUARA –NË PERIU DHËN JANAR-GUSHT 2023, KRAHASUAR ME JANAR-GUSHT 2022.

Sipas llojit	Viti 2022	Viti 2023	Dallimi në %
Aktiviteti i Jetës	325	278	-14.46%
Aktiviteti i Jo-Jetës	109.323	121.112	+10.78%
Total:	109.648	121.39	+10.71%

650

MILIONË EURO DËME U PAGUAN NGA SIGURIMET

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) shihet se nga viti 2003 e deri në fund të muajit gusht të këtij viti, kompanitë e sigurimit të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) kompensuan dëme për palët e dëmtuara në vlerë prej hiç më pak se 650 milionë euro. Sidomos gjatë viteve të fundit kemi rritje të theksuar të pagesës së dëmeve.

Hiç më pak se 650 milionë euro ka arritur shuma e mjeteve që kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) kanë paguar nga viti 2003 e deri më tash, pra për rreth 21 vjet. Referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se sidomos gjatë viteve të fundit kemi rritje të dukshme të pagesës së dëmeve për palët e dëmtuara si atyre në aksidente komunikacioni, por edhe në aspekt shëndetësorë.

DËMET E PAGUARA 2003-2023

Bazuar në të dhëna zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se në vitin 2003 kompanitë e sigurimeve si dhe BKS-ja paguan dëme në vlerë prej 5.6 milionë euro, derisa në vitin 2004 paguan dëme në vlerë prej 6.7 milionë euro. Në vitin 2005 sipas të dhënave të BQK-së shihet se kompanitë e sigurimeve paguan dëme në vlerë prej 9.2 milionë euro, deri sa një vit më vonë 2006 paguan dëme në vlerë prej 10.9 milionë euro. Gjithashtu në vitin 2007 kompanitë e sigurimeve si dhe BKS-ja paguan dëme në vlerë prej 12.8 milionë euro, në vitin 2008 paguan dëme në vlerë prej 17,7 milionë euro deri sa në vitin 2009 shuma e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve ishte 18.8 milionë euro. Në vitin 2010 sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se kishte një ngritje të dukshme të pagesës së dëmeve, ku

brenda vitit u paguan 26,5 milionë euro, e një vit më vonë, pra 2011 u paguan nga kompanitë e sigurimeve e Byroja Kosovare e Sigurimit hiç më pakë se 26.8 milionë euro. Gjithnjë referuar të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se në vitin 2012 kompanitë e sigurimeve si dhe Byroja Kosovare e Sigurimit paguan 30.6 milionë euro, derisa në vitin 2013 i paguan 38.4 milionë euro. Në vitin 2014 u paguan 31.2 milionë euro, derisa në vitin 2015 u paguan 37 milionë euro. Gjithashtu edhe në vitin 2015 kompanitë paguan dëme në vlerë prej 37 milionë euro për palët e dëmtuara, derisa në vitin 2016 shuma e dëmeve të paguara ka arritur në 36.9 milionë euro. Në vitin 2017 shuma e dëmeve të paguara ishte 42.2 milionë euro, derisa në vitin 2018 shuma totale e dëmeve të paguara kishte arritur në 42.8 milionë euro. Në vitin 2019 sipas të dhënave zyrtare shuma e dëmeve të paguara kishte arritur në 50 milionë euro, deri sa në vitin 2020 shuma e dëmeve të paguara ishte 47 milionë euro. Në vitin 2021 shuma e dëmeve të kompensuar nga Byroja Kosovare e Sigurimit e kompanitë e sigurimeve kishte arritur në 54.1 milionë euro, deri sa në vitin 2022 kishte arritur rekordin në 57.7 milionë euro. Gjithashtu, gjatë periudhës janar-gusht 2023 shuma e dëmeve të paguara ka arritur në 47.6 milionë euro.

Viti	Pagesa e dëmeve (milion €)
2003	5.6
2004	6.7
2005	9.2
2006	10.9
2007	12.8
2008	17.7
2009	18.8
2010	26.5
2011	26.8
2012	30.6
2013	38.4
2014	31.2
2015	37.0
2016	36.9
2017	42.2
2018	42.8
2019	50.0
2020	47.0
2021	54.1
2022	57.7
2023	47.6
Total:	650.4

KUSHTET E PËRGGJITHSHME TË POLICËS SË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGGJEGJËSIA – TPL

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TË SIGURUARIT ME POLICËN TPL



Pronari/shfrytëzuesi i mjetit motorik është i obliguar të kontraktojë/blejë sigurimin e detyrueshëm të auto përgjegjësisë për dëmet që mund t'u shkaktohen palëve të treta në rast të lëndimeve, dëmtimit të shëndetit në rast vdekjeje, apo dëmtimit të pasurisë gjatë përdorimit të tij.



Siguruesi është kompania e sigurimit e licencuar nga BQK për të zhvilluar aktivitete të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë.



I siguruari - personi, interesi pasuror i të cilit është siguruar në rast përgjegjësie nga posedimi dhe përdorimi i mjetit motorik.

Drejtuesi i automjetit është i detyruar të mbajë me vete policën e sigurimit të autopërgjegjësisë, si dhe ta paraqesë atë sa herë i kërkohet nga personi zyrtar. Në rast të mos posedimit të dëshmisë se mjeti motorik është i siguruar, Policia e Trafikut do të kontaktojë Qendrën Informativë të Sigurimeve për të verifikuar nëse mjeti motorik është i siguruar, dhe nëse vërtetohet se mjeti motorik nuk është siguruar në mënyrë të rregullt, Policia e Trafikut do të parandalojë shfrytëzimin e mëtejshëm të mjetit motorik.

Mjet motorik konsiderohet mjeti që lëviz në tokë me anë të fuqisë mekanike (vetura, motoçikleta, autobusi, kamioni, traktori, rimorkioja dhe gjysmë rimorkioja të bashkuara ose jo me mjetin motorik tërheqës, etj.) por jo mbishina, për të cilat parashihet të regjistrohen dhe pajisen me dokument regjistrimi para se të fillojë përdorimi i tyre.

Kompania e sigurimit është e detyruar që së bashku me policën e sigurimit, t'ia dorëzojë të siguruarit edhe formularin e “Raportit evropian të aksidentit”. Pjesëmarrësit e përfshirë në një aksident rrugor, përveç raportit të aksidentit të hartuar nga policia rrugore, duhet të plotësojnë, nënshkruajnë dhe shkëmbejnë formularin e “Raportit evropian të aksidentit” si dëshmi për aksidentin me rastin e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim.

Mjetet motorike të KFOR-it dhe me prefiks UN, EU, OSCE dhe CD, duhet të kenë dëshmi sigurimit të autopërgjegjësisë të pranueshme nga BQK. Në rast aksidenti, drejtuesi i automjetit është i detyruar të japë të dhënat personale dhe të dhënat që lidhen me sigurimin e autopërgjegjësisë, të gjithë personave të përfshirë në aksident.

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË POLICËS SË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA

SIGURIMI NGA AUTOPËRGJEGJËSIA MBULON:



Dëmet e shkaktuara palëve të treta, në persona dhe pasuri gjatë përdorimit (shfrytëzimit) të mjetit motorik si dhe nga rënia e sendeve apo çdo gjë tjetër që është i lidhur nga mjete motorik.



Dëmet e shkaktuara palëve të treta, nga përdorimi i mjetit motorik nga drejtuesi i paautorizuar i mjetit motorik.

SIGURIMI NGA AUTOPËRGJEGJËSIA NUK MBULON

Drejtuesin e mjetit motorik i cili është përgjegjës për aksidentin



Bashkudhëtarin që me vullnetin e vet ndodhet në mjetin motorik me përdorimin e të cilit është shkaktuar dëmi, kur vërtetohet nga siguruesi se bashkudhëtari ishte në dijeni se automjeti ishte i pasiguruar apo i vjedhur.



Personin e dëmtuar për shkak të përdorimit të mjetit motorik në manifestime sportive në rrugë apo pjesë rrugësh të palejuara për gara



Pasojat gjatë transportit të materialeve radioaktive; -operacionet apo manovrat ushtarake, revoltat apo aktet tjera nese dëshmohet se dëmi është shkaktuar nga ngjarjet e tilla; veprimet të fuqisë madhore si dhe rastet tjera të përjashtuara me Ligj.

HUMBJA E MBULESËS SIGURUESE (TË DREJTËS PËR KOMPENSIM)



-I siguruari e humb mbulesën siguruese, kur mjeti motorik nuk përdoret në pajtim me destinimin (si p.sh. kur vetura zyrtare përdoret për qëllime private, autoambulanca vozitet nga personi i pautorizuar, etj).



-Drejtuesi nuk ka leje të vlefshme për drejtim të mjetit motorik, përveç rasteve të përdorimit të mjetit motorik gjatë mësimëve të drejtimit të mjetit nga kandidati i autoskollës.



-Mjeti motorik drejtohet nën ndikimin e alkoolit mbi kufijtë e lejuar, nën ndikimin e lëndëve narkotike apo psiko-aktive.

-Drejtuesi shkakton dëmin me dashje apo aksidenti ndodh për shkak të defekteve teknike të mjetit për të cilat drejtuesi, poseduesi apo pronari kanë qenë në dijeni.



Humbja e të drejtave të lartpërmendura nga sigurimi, nuk ndikon në të drejtën e palës së tretë për dëmshpërblim

KUSHTET E PËRGGJITHSHME TË POLICËS SË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGGJEGJËSIA

PARASHTRIMI I KËRKESËS PËR DËMSHPËRBLIM NGA PALA E DËMTUAR



-I dëmtuari ka të drejtë që kërkesën për dëmshpërblim nga baza e sigurimit TPL, ta parashtojë drejtpërdrejt te kompania e sigurimit përgjegjëse (kompania në të cilën shkaktori i aksidentit e ka kontraktuar/blerë policën e sigurimit TPL).



Ndërsa në rastet kur dëmi shkaktohet:

- nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk posedon policën e sigurimit TPL,

- nga mjeti motorik i pasiguruar me regjistrim të huaj, apo

- nga mjeti motorik i paidentifikuar, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim nga Byroja e Sigurimeve të Kosovës.

DETYRIMET E SIGURUESIT (KOMPANISË SË SIGURIMIT) LIDHUR ME PROCEDURAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË KËRKESAVE PËR DËMSHPËRBLIM

-Siguruesi duhet të regjistrojë kërkesën për dëmshpërblim në librin/evidencën e posaçme të dëmeve dhe në afat prej tre ditësh të vërtetojë pranimin duke njoftuar palën me referencën e kërkesës së evidentuar dhe nëse kërkesa nuk është e kompletuar duhet që më së largu në afat prej tri ditësh nga dita e pranimin të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin rreth dokumentacionit shtesë të kërkuar.

-Kompania e Sigurimit është e detyruar që për dëmet në pasuri, më së largu në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh ndërsa për dëmet në persona, më së largu në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës për dëmshpërblim, të trajtojë kërkesën dhe të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar me ofertën për dëmshpërblim apo arsyen e refuzimit të kërkesës-

- Nëpërmjet sistemit elektronik <https://ankesat.bqk-kos.org>
- Nëpërmjet adresës postare: Rr. Garibaldi nr. 33, Prishtinë
- Duke e dorëzuar personalisht në zyrën e arkivit të BQK-së
- Nëpërmjet fax-it (por jo telefonit)

Nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen e ofruar ose nuk merrni përgjigje brenda afatit të përcaktuar, atëherë ju mund t'i drejtoheni BQK-së. Ankesën tuaj së bashku me të gjitha dokumentet mbështetëse duhet ta paraqitni në njërin nga mënyrat në vijim: BQK do ta shqyrtojë ankesën tuaj dhe brenda 15 ditësh do t'ju informojë për vlerësimin dhe zgjidhjen e rekomanduar, por varësisht nga kompleksiteti i rastit mund të kërkohej afat shtesë. Nëse nuk jeni të kënaqur me rekomandimet e BQK-së atëherë ju mund të kërkonit zgjidhje nëpërmjet rrugëve tjera ligjore.

SISTEMI BONUS-MALUS

Bazuar në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, BQK ka nxjerrë rregulloren <https://bqk-kos.org/edu/wpcontent/uploads/2017/05/bonus-malus-pdf-shqip-korrigjuar.pdf>, për zbatimin e Sistemit Bonus -Malus, ku secilit të siguruar në Kosovë, që ka kontratën (policën) e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia me afat të paktën një vit, niveli i primit i caktohet sipas shkallëve të sistemit bonus-malus, varësisht nga fakti nëse në periudhën e kaluar të sigurimit ka pasur dëme të deklaruara apo jo. Kjo nënkupton se nga Bonusi do të përfitojnë shoferët e kujdesshëm në trafik, të cilët nuk kanë shkaktuar aksidente, ndërsa nëpërmes Malusit shoferët e papërgjegjshëm të cilët kanë shkaktuar aksidente do të jenë në disavantazh.
Burimi: BQK

Rritet për 35,11 % shitja e policave për sigurimin e sëmundjeve

Gjatë dy muajve të parë të këtij viti, respektivisht janar dhe shkurt shitja e policave për sigurimin e sëmundjeve është rritur për 82 % në raport me

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Duke iu referuar të dhënave zyrtare shihet se gjatë muajit janar dhe shkurt të këtij viti janë shitur 68,065 polica për sigurimin e

sëmundjeve, derisa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë shitur 37,377 polica për sigurimin e sëmundjeve, e ku shihet një rritje prej 82 %.



Shitja e policave TPL u rrit për 8,33 %

Sipas të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se vetëm gjatë periudhës janar-gusht të këtij viti, kompanitë e sigurimeve në Kosovë kanë

shitur 298,537 polica TPL e brendshme, e nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njëjte të vitit paraprak shihet se shitja e policave gjatë periudhës janar-gusht 2023

është më e lartë për 8,33 % në raport me muajin janar-gusht 2022, ku sipas të dhënave zyrtare në atë muaj janë shitur 275,580 polica TPL e brendshme.



12 % është rritur shitja e policave TPL Plus

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë periudhës janar-gusht të këtij viti kompanitë e sigurimeve në vend

kanë arritur të shesin 77,376 polica TPL Plus, nga 69,088 sa i kishin shitur gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Nëse bëjmë një përllogaritje shihet se

shitja e policave TPL Plus gjatë muajit janar-gusht është rritur për 12 % më shumë në raport periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



9,3 % % rritet shitja e policave kufitare

Gjatë periudhës janar-gusht të këtij shitja e policave kufitare është rritur për 9,3 % në raport me muajin janar të vitit që lamë

pas. Referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë muajit janar – gusht të këtij viti janë shitur

362,137 polica kufitare, nga 331,330 polica kufitare sa janë shitur gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

362,137
polica kufitare janë shitur gjatë periudhës janar-gusht 2023.

331,330
polica kufitare janë shitur gjatë periudhës janar-gusht 2022.

9,3 %
është rritur shitja e policave kufitare gjatë periudhës janar-gusht 2023 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

5343 polica për sigurim nga zjarri

Gjatë muajve janar-gusht këtij viti kompanitë e sigurimeve në vend kanë shitur 5343 polica sigurim nga zjarri, nga 5370 polica sigurim nga zjarri janë shitur

gjatë muajit janar dhe shkurt 2022. Duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë periudhës janar-gusht të këtij viti shitja

policave është më vogël për 27 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

5343
polica sigurimi nga zjarri janë shitur gjatë periudhës janar-gusht 2023.

5370
polica sigurimi nga zjarri janë shitur gjatë periudhës janar-gusht 2022.

27
polica të sigurimit nga zjarri janë shitura më pakë gjatë periudhës janar-gusht 2023 në raport me periudhën janar-gusht 2022.

13,133 polica për sigurim të mjeteve tokësore

Gjithnjë duke iu referuar të dhënave zyrtare të Bankës Qendrore të Kosovës shihet se gjatë periudhës janar - gusht të këtij viti kompanitë e sigurimeve në vend kanë

shitur 13,133 polica për sigurim të mjeteve tokësore, ndërsa 11,162 polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë muajve janar-gusht 2022. Nëse bëjmë një krahasim

të thjeshtë shihet se 17,66 % është rritur shitja e policave për sigurimin e mjeteve tokësore gjatë periudhës janar-gusht 2023 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

13,133
polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë periudhës janar-gusht 2023.

11,162
polica për sigurim të mjeteve tokësore janë shitur gjatë periudhës janar-gusht 2022.

17.6%
është rritur shitja e policave TPL plus gjatë periudhës janar-gusht 2023 në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.



BQK: SEKTORI I SIGURIMEVE SEKTORI I SIGURIMEVE SHËNOI RRRITJE TË LARTË TË AKTIVITETIT

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) na raportin tre mujor të vlerësimit të ekonomisë për tremujorin e parë të këtij viti ka vlerësuar se sektori i sigurimeve shënoi rritje të lartë të aktivitetit për të katërtin vit me radhë edhe përkundër sfidave me cilat u përball sektori dhe i gjithë sistemi financiar në vend.

Sipas raportit të BQK-së asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.9 përqind të gjithë asetëve të sistemit financiar në fund të marsit 2023.

“Vlera e gjithëj asetëve në fund të periudhës arriti në 289.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 15.5 përqind, duke vazhduar trendin e rritje dyshifrore në katër vitet e fundit (grafik 40). Zgjerimi i sektorit kryesisht erdhi si rezultat i rritjes së rezervave teknike, që burojnë nga primet e shkruara, si dhe kapitalit vetanak (kapitalit aksionar dhe fitimit të realizuar). Në kuadër të asetëve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale,

që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënoi rritje në këtë tremujor krahasuar me gjendjen në mars 2022” thuhet në raportin e BQK-së.

Më tutje aty thuhet se vlera e primeve të shkruara në tremujorin e parë të vitit 2023 arriti vlerën prej 34.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 15.1 përqind.

Sipas tyre, rritja e primeve të shkruara reflekton kryesisht rritjen e primeve të shkruara të kategorisë ‘aksidenti dhe shëndeti’ në kuadër të sigurimit vullnetar dhe ‘përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë’ në kuadër të sigurimit të detyrueshëm.

“Primet e shkruara ndaj sigurimit të detyrueshëm vazhdojnë të kenë peshën më madhe, prej 53.2 përqind të gjithëj primeve të shkruara jo-jetë. Rritja e primeve në kuadër të sigurimit ‘aksidenti dhe shëndeti’ (për 25.8 përqind) është sinjal pozitiv për rritje të num-

rit të qytetarëve që posedojnë sigurim shëndetësor. Përderisa, rritja e primeve të sigurimit të detyrueshëm reflekton kryesisht kategorinë e ‘sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë - MTPL’, që shënuan rritje për 10.2 përqind” thuhet në raportin e vlerësimit tre mujor të ekonomisë të hartuar nga BQK-ja.

Në anën tjetër, vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve në tremujorin e parë të vitit 2023 arriti vlerën prej 19.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 35.0 përqind.

Sektori i sigurimeve në tremujorin e parë të vitit 2023 realizoi fitim në vlerë prej 2.3 milionë euro (0.4 milion euro në periudhën e njëjtë të një viti më parë).

Vlera më e lartë e fitimit të realizuar kundrejt vitit të kaluar erdhi si rezultat i vlerës më të lartë të hyrave të arkëtuara nga primet e shkruara krahasuar me vlerën e shpenzimeve për dëmet të paguara

MAKOLLI: KEMI DHËNË MAKSIMUMIN, SIVJET NUK KA PASUR PRITJE

Për të marrë një policë kufitare, në një nga pikat kufitare të Kosovës, sivjet pothuajse nuk ka pasur pritje fare. Përgatitja para kohe, si dhe puna me orar të zgjatur e kanë dhënë efektin e vet. Koordinatori i pikave kufitare në Byronë Kosovare të Sigurimit, Liridon Makolli, gjatë një bashkëbisedimi tregon për angazhimin e tij dhe stafit të tij sidomos gjatë sezonës së verës. Makolli tregon se pjesa dërmuese e makinave që hyjnë në vendin tonë janë nga Gjermania dhe Zvicra, derisa ai veçon se deri në fund të muajit shtator një veturë nga Meksika dhe 18 nga Rusia janë pajisur me polica sigurimi.

Thuajse pa pritje fare, sivjet bashkatdhetarët janë pajisur me polica sigurimi nëpër pikat kufitare ku janë të vendosura kabinat e Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS). Një parapërgatitje nga menaxhmenti, por edhe një angazhim i shtuar i stafit ka dhënë rezultate të dukshme, nëpër pikat kufitare pritje nuk ka pasur thuajse fare.

Liridon Makolli, koordinatori i pikave kufitare në Byronë Kosovare të Sigurimit tregon se në kohë të caktuara sivjet ka pasur fluks të madh të bashkatdhetarëve tanë, që kanë ardhur për pushime në vendin tonë. Sipas tij, korriku dhe gushti janë dy muajt kur pjesa më e madhe e diasporës vjen në vendlindje për pushime.

“Fluksi në kohë të caktuara ka qenë shumë i madh, por ne kemi bërë përgatitje paraprake në mënyrë që t’i eliminojmë pritjet dhe këtë e kemi arritur me shumë sukses. Sivjet punëtorët kanë punuar edhe me orar të stërzgatur, por edhe ku ka pasur nevojë kemi shtuar numër të punëtorëve, në mënyrë që bashkatdhetarët tanë të mos presin fare kur të hyjnë në Republikën e Kosovës”, tregoi ai.

Më tutje Makolli tregoi se sikurse në vitet e kaluara edhe sivjet pjesa dërmuese e veturave që kanë ardhur në Kosovë e që janë të obliguar të pajisen me policë kufitare janë nga Gjermania, duke u pasur nga Zvicra, Austria, Maqedonia e Veriut, Italia, Sllovenia, Franca dhe Britania e Madhe. Sipas tij, në Kosovë kanë hyrë vetura nga më shumë se 80 shtete, por numri i tyre është i vogël.



“Ta zëmë, sipas të dhënave që ne kemi, deri në fund të muajit shtator në Kosovë 1 veturë ka hyrë nga Meksika, nga Uruguai 1, nga Kazakistan po ashtu 1, nga Egjipti gjithashtu 1 veturë ka hyrë gjatë kësaj periudhë kohore, derisa nga Iraku, Katari, Qipro, Brazili, Libani kanë hyrë nga 2 vetura nga fillimi i vitit

e deri në fund të muajit shtator të këtij viti”, ka treguar më tutje koordinatori Makolli.

Ai tregon se për dallim nga vitet paraprake kushtet e punës së punëtorëve nëpër pikat kufitare janë dukshëm më të mira, pasi që sipas tij menaxhmenti ka bërë investime të vazhdueshme në përmirësimin e kushteve.

RRITJE DYSHIFRORE

Sektori i sigurimeve shënoi rritje dyshifrore për të dytin vit me radhë, rritje të konsiderueshme të primeve të shkruara dhe performancë financiare më të lartë krahasuar me vitet e fundit. Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.9 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar në fund të qershorit 2023. Vlera e gjithsej aseteve në fund të qershorit 2023 arriti në 294.2 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 16.0 përqind (grafik 39). Zgjerimi i sektorit kryesisht erdhi si rezultat i rritjes së rezervave teknike, që burojnë nga primet e shkruara si dhe kapitalit vetanak të siguresëve. Në kuadër të aseteve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara.

Kategoria e dytë për nga pesha, ajo e Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës, shënoi rritje krahasuar me gjendjen në qershor 2022, por që është më e ngadalësuar si rrjedhojë e nivelit më të ulët të borxhit të emtuar nga Qeveria e Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2023 (emetime të reja vetëm gjatë periudhës janar-mars 2023). Vlera e primeve të shkruara në fund të qershorit 2023 arriti vlerën prej 70.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 14.5 përqind. Rritja e primeve të shkruara reflekton kryesisht rritjen e primeve të shkruara të kategorisë ‘sigurimi i sëmundjeve’ në kuadër të sigurimit vullnetar dhe ‘përgjegjësisë motorike ndaj palës së tretë’ në kuadër të sigurimit të detyrueshëm. Primet e shkruara ndaj sigurimit

të detyrueshëm vazhdojnë të kenë peshën më madhe, prej 54.5 përqind të gjithsej primeve të shkruara jo-jetë. Rritja e primeve në kuadër të ‘sigurimit të sëmundjeve’ (për 20.8 përqind) është indikacion pozitiv për rritje të numrit të qytetarëve që posedojnë sigurim (polica) shëndetësore. Për më tepër, edhe numri i policave për këtë kategori është rritur në 173.3 mijë sosh nga 115.8 mijë sa ishin në fund të qershorit 2022. Ndërsa, rritja e primeve të sigurimit të detyrueshëm reflekton kryesisht kategorinë e ‘sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë – MTPL e brendshme’ dhe ‘MTPL+’, që shënuan rritje vjetore për 8.6 përkatësisht 15.8 përqind, thuhet në raportin tre mujor të vlerësimit të Ekonomisë së BQK-së

Aksidentet u rritën për 10,41 %

Gjatë periudhës janar-gusht 2023, sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, aksidentet në komunikacion janë rritur për 10,41 % në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Pra, gjatë periudhës janar-gusht 2023 në Kosovë janë regjistruar 15,662 aksidente komunikacioni, nga 14,149 sa ishin gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak

Edhe më tutje vazhdojnë të rriten aksidentet me dëme materiale, e pa persona të lënduar. Sipas të dhënave zyrtare të Policisë së Kosovës shihet se 9779 aksidente me dëme materiale kanë ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-gusht 2023, nga 9779 aksidente me dëme materiale sa ishin gjatë periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Duke e bërë një krahasim shihet se 10,36 % është rritur numri i aksidenteve me dëme materiale gjatë periudhës janar-gusht 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore kemi rritje të dukshme edhe të aksidenteve me lëndime ku gjatë periudhës janar-gusht 2023 janë evidentuar 5779, nga 5223 aksidente me lëndime sa kishin ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-gusht 2022. Pra, kemi një rritje prej 10,65 % të aksidenteve me lëndime në vendin tonë. Dersa kemi rritje të aksidenteve me lëndime dhe atyre me dëme materiale, gjatë kësaj periudhe kohore kemi rënie për 1,54 % të aksidenteve më fatalitet. Për 8 muaj në vendin tonë janë regjistruar 64 aksidente më fatalitet, nga 65 sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë vitit 2023, shihet se sipas të dhënave zyrtare 69 persona kanë humbur jetën, deri sa gjatë periudhës janar-gusht 2023 jetën në aksidente komunikacioni e kishin humbur 74 persona.

hës janar-gusht 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore kemi rritje të dukshme edhe të aksidenteve me lëndime ku gjatë periudhës janar-gusht 2023 janë evidentuar 5779, nga 5223 aksidente me lëndime sa kishin ndodhur në Kosovë gjatë periudhës janar-gusht 2022. Pra, kemi një rritje prej 10,65 % të aksidenteve me lëndime në vendin tonë. Dersa kemi rritje të aksidenteve me

lëndime dhe atyre me dëme materiale, gjatë kësaj periudhe kohore kemi rënie për 1,54 % të aksidenteve më fatalitet. Për 8 muaj në vendin tonë janë regjistruar 64 aksidente më fatalitet, nga 65 sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Gjatë vitit 2023, shihet se sipas të dhënave zyrtare 69 persona kanë humbur jetën, deri sa gjatë periudhës janar-gusht 2023 jetën në aksidente komunikacioni e kishin humbur 74 persona.



	2022	2023	Krahasimi janar-gusht 2022 - 2023
Aksidente me fatalitet kanë ndodhur në Kosovës	65	64	-1.54%
Persona kanë humbur jetën në aksidentet me fatalitet	74	69	-6.76%
Aaksidente me lëndime	5,223	5,779	+10.6%
Persona të lënduar në aksidente komunika- cioni	9,918	11,312	+14%
Aaksidente me dëme materiale	8,861	9,779	+10%
Aksidente komunikacioni	14,149	15,622	+10.4%

SIGURIMET NË NUMRA

98,612,851€

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në fund të muajit gusht të këtij viti.

11,742

dëme janë paguar më shumë gjatë periudhës janar-gusht 2023 më shume se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

12.66%

është rritur tregu i sigurimeve gjatë periudhës janar-gusht 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak

11,082,997€

është rritur volumi i primeve të shkruara bruto gjatë periudhës janar-gusht 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

1,067,748

ka arritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetaret në fund të muajit gusht të këtij viti.

17.22%

është rritur numri i kontratave të kompanive të sigurimit me qytetaret në fund të muajit gusht të këtij viti, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

121,390

dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimeve, por edhe Byroja Kosovare e Sigurimeve vetëm gjatë periudhës janar-gusht të vitit 2023

94,060,338€

ka arritur vuolimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës deri në fund të muajit gusht të këtij viti

13,19%

është rritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës deri në fund të muajit gusht të këtij viti

4,552,513 €

ka arritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës deri në fund të muajit gusht të këtij viti.

2.82%

është rritur volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës deri në fund të muajit gusht të këtij viti në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

42,257

ka arritur numri i kontratave në sigurimin e jetës në fund të muajit gusht të këtij viti

67.79%

është rritur numri i kontratave në sigurimin e jetës gjatë periudhës janar-gusht 2022, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Performanca e sektorit të sigurimeve gjatë periudhës janar 2023, në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.